



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 37 datë 30-03-2023

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES TË DATËS 23.02.2023
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **23.02.2023**, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës **23.02.2023** bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 31-03-2023

K R Y E T A R

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 23.02.2023

Kryesuesi i mbledhjes është Kryetari i Këshillit Bashkiak z. Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 26

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 26

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 1

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me rendin ekzekutivi ka diçka?

Sekretare E.Naçi: Është një material shtesë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo për mbështetjen?

Ekzekutivi A.Dishnica: Dje është paraqitur në sekretarinë e këshillit edhe një material PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË APLIKANTËVE (BANORË TË BASHKISË KORÇË) NË VIJIM TË PROGRAMIT TË QEVERISË SHQIPTARE "PROGRAMI I KODIMIT" dhe kërkon qetë futet në rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni e ka parë? Johan?

Këshilltar J.Deli: Jemi në konflikt interesi dhe më duhet dhe të tërhiqem dhe nga votimi në rastin e pikës së fundit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Do i marrësh ti paratë? Ne nuk përcaktojmë emra këtu, përcaktojmë kritere i plotëson nuk i plotëson. Këtu ne nuk ndajmë gjë, vendosim përcaktojmë fonde dhe kritere. Në lidhje me rendin e ditës pra siç e shpërndamë këtu materialin që ka lidhje me këtë programin për mbështetjen e të rinjve. Ka ndonjë sugjerim nga këshilltarët? Pra ky material shtohet në pika 7, pika 7 dhe në vijim zhvendoset më poshtë. Kush është dakord me rendin e ditës më ndryshimin e paraqitur?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PROCEVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25-JANAR 2023 DHE TË DATËS 09-SHKURT 2023.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Pati ndonjë problem me zbardhjen e materialit Eva.

Sekretare E.Naçi: Jo mbledhja ishte regjistruar dhe transmetuar e gjitha.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 JANAR 2023.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj:Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social, Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK.Për periudhën Janar janë 33familjepërfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë,familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022.Për muajin Janar 2023, është në dispozicion fondi prej 252.980 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike , nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 33 familje,të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 107.787 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 11familje, në shumën 12.872 lekë. Pagesa totalenga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 120.659 lekë.Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara16 familje,me fond prej 53.795lekë. Të bëj një rregullim teknik që ka

tëbëjë me dokumentin që një përfituese i është 2-fishuar ndihma ekonomike por për shkaqe teknike nuk është arritur të paraqitet në dokument. Pra në sistem është në rregull, këtu është e parregulluar. Pra nga shuma që ka dyfishohet dhe bëhet më shumë. Me këtë rregullim teknik ftoj këshilltarët ta miratojnë relacionin për dhënien e ndihmës ekonomike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË".

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Relacioni për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit me titullin "Subvencionimi i interesave të kredisë" ka përcaktuar sipas përcaktimeve ligjore listën e familjeve e cila gjatë periudhës që ka kaluar nga shpërndarja e materialeve deri sot kanë plotësuar kushtet edhe 2 persona të tjerë. Kështu që rregullimi që do të bëhet është +2 persona që kanë plotësuar kushtet dhe janë përfshirë në listën e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit Subvencionim i interesave të kredisë që merren me 8 persona dhe jo me 6 si në dokumentacionin që keni ju. Ftoj këshillin bashkiak ta miratojë këtë listë të përfituesve si një nga programet që bashkia Korçë e ka përdorur për të mbështetur familjet të cilat nuk mundet të kenë një perspektivëstrehimi përmes formave të tjera.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Nga ekzekutivi ka diçka?

Ekzekutivi M.Balli: Dua të ritheksoj edhe njëherë faktin që në momentin që dorëzohen dokumentat 2 nga aplikantët arritën të plotësonin dokumentacionin dhe nga 6 u bënë 8. Dhe kjo ështëçështje kohe.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka një fakt qëçmimet e ndërtsave janë rritur ndjeshëm këto vitet e fundit dhe ne besojmë të vazhdojmë siç kanë qënë këto kuotat që mbështesim që financojmë në kuptimin që mbështeten. Varet nga ne apo me vendim më lart për të rritur këtë pragon e financimit. Nuk e kam shumë të qartë këtë.

Ekzekutivi M.Balli: Kjo nuk varet nga ne. Kjo është një marrëveshje që Ministria e Financave ka bërë më 3 bankat e nivelit të dytë Raiffeisen, Intesa SanPaolo dhe BKT dhe kuotat që kemi të lira

janë të periudhës 2019-2022. Edhe ne e kemi përcjellë si shqetësim sepse tregon që pavarësisht se ne kemi miratuar një listë goxha më të madhe sesa janë përfituesit tregon që ka vështirësi të gjetjes në treg, por argumentohet me faktin që nuk ka ndryshuar çmimi i shitjes në treg. Pra ajo që është e përcaktuar me udhëzim, nuk ka asnjë ndryshim nga viti 2016 e deri më sot dhe për këtë i referohen tenderave të cilat në një farë mënyre kur konkurrohen gjithmonë janë poshtë vlerës dhe e shikojnë si argument për të mos ndryshuar vlerën e apartamentit. Nuk varet nga ne.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani çmimet kanë ndryshuar, e vërtetë është, mirëpo ajo që tha Mirela është që nuk është kompetenca jonë, pra pjesë e paketës të dokumentave që na ka erdhur ne janë jo vetëm kuotat por edhe masat që mbështet për çdo apartament sipas strukturës. Po themi apartament 1+1 masin shumë që mbështet në këtë interesin e sbuvencionimit dhe është X dhe është e përcaktuar, për apartamente 1+1 kaq lekë do marrësh në interes të subvencionuar, pjesën tjetër të diferencës duhet ta vendosësh vetë. Dmth është e përcaktuar që në paketën e dokumentave që na ka ardhur, nuk është se është lënë bashkisë për të bërë vlerësim. E vetmja gjë që mund të bëjmë është që ta përcjellim si shqetësim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë mbase mund të behet ndonjë index prapë zyrtar, publik. Është një shqetësim që. Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit tëditës

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMI NR.25 DATË 28.02.2019 PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PRIVATIZIMIN E OBJEKTIT TË ISH NDËRMARRJES SË GRUMBULLIMIT TË DRITHIT".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo

Këshilltar Gj.Kristo:Me Vendim nr.25 datë 28.02.2019 Këshilli Bashkiak Korçë ka miratuar dhënie e dakordësisë për privatizimin e objektit të Ish Ndërrmarjes së Grumbullimit të Drithit Korçë, pasuri me nr.3/716 vol.33 fq.122 ndërtesë me sipërfaqe 2860 m2 ZK 8564 me adrese Rruga Petraq Shomo.Me shkresë të datës 02.12.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka kërkuar Bashkisë Korçë informacion të detajuar mbi objektet që përfshihen në këtë procedurë privatizimi. Kjo pas pretendimeve të anëtarëve të familjes Nene, përfitues të së drejtës së parablerjes mbi këto pasuri, referuar Vendimit të Gjykatës nr.3026 datë 01.12.1995 regjistruar në regjistrat hipotekorë. Trashëgimtarët e familjes Nene kanë privatizuar në vitin 1996 objektin "Fabrika e Çembrionizimit", objekti nr.9, sipas skicës nr.2 pjesë e Vendimit të Gjykatës nr.3026 datë 01.12.1995. Sipas kontratës së shitjes të datës 18.09.1996 dhe aktit të dorëzimit të po të njëjtës datë, referuar mandat arkëtimeve për

likuidimin e vlerës së objektit dhe autorizimit për blerje objekti të datës 28.08.1996, "Fabrika e Çembrionizimit" me sipërfaqe 4646 m2, sipas genplanit bashkangjitur kontratës së shitjes, është privatizuar nga pala blerëse Jovan Blushi, Pandush Face, Kristaq Kafexhi, Safer Zemblaku dhe Klotilda Buri. Si rrjedhojë, ky objekt nuk duhet të përfshihet në Vendimi nr.25 datë 28.02.2019 i Këshillit Bashkiak Korçë. Kjo pasuri përfshin 12 objekte nga të cilat janë të pasqyruara në skicat 1 dhe 2 dhe janë të rregjistruara në rregjistrat hipotekore pranë agjensisë shtetërore të kadastrës dhe aktualisht mbetet kërkesa për privatizim të objektit 5,6,7 dhe 8. Me propozim edhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i propozoj këshillit të përjashtojë objektin 9.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Këshilltar Sh.Kajmaku: Nuk ka diçka, ne e kemi miratuar njëherë thjesht kërkohet përjashtimi i objektit i cili është i privatizuar, konkretisht "Fabrikën e Çembrionizimit".

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

"PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË 30% TË TRUALLIT TË DHËNËPËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT "SHITESË SHESHI NË DRENICË PËR OBJEKTIN MAGAZINË PRODHIMI FIRMËS KORÇA NDËRTIM PRODHIM" NGA KRT KORÇË, ME VENDIM NR.380 DATË 12.09.1998 NË FAVOR TË Z.ROLAND ZEGULLAJ, PËR EFEKT REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo.

Këshilltar Gj.Kristo: Konkretisht me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.329 datë 22.05.2019 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e mardhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi". Janë tokat e dhëna për qëllime ndërtimi nga Bashkitë, ish-komunat dhe ish-këshillat e rretheve, pas datës 10.08.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.24/2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr.1070 datë 22.04.2010 Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksë mbi të drejtën e përdorimit të tij". Përfitojnë nga ky Vendim, midis të tjerësh, edhe subjektet që nuk janë pajisur nga organet vendore me dokumentacion pronësie mbi tokën, por për ta është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e truallit për ndërtim, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Në këto kushte pranë Bashkisë Korçë më datë 11.10.2022 me nr.8650 Prot. është paraqitur kërkesa nga ana e Z.Ardi Fezga "Kërkesë për shlyerje të detyrimit (30%) të prapambetur të tokës së blerë pranë Këshillit të Qarkut". Z.Ardi Fezga është përfaqësues

me prokurë i subjektit i cili pretendon fitimin e pronësisë në këtë truall. Është bërë rregjistrimin pranë truallit të rregjistrimit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ai e posedon, është thjesht procedurë.

Këshilltar Gj.Kristo: Thjesht procedurë, konkretisht dokumentacioni i kërkuar është që të jetë miratuar vendimi i Këshillit sikurse e thamë, dhe konkretisht konkretisht likuidimi i 30% të vlerës së truallit dhe akti i kalimit të pronësisë për 30% të truallit. Në këto kushte pasi është plotësuar mandati nga ana e bashkisë, ka kryer pagesën për shlyerjen e kësaj vlere prej 30% dhe ka depozituar dhe mandatin e arkëtimit pranë bashkisë Korçë. Në këto kushte kërkojmë që të jepet dakordësia.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nga këshilltarët diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Pika 7 e rendit të ditës

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË APLIKANTËVE (BANORË TË BASHKISË KORÇË) NË VIJIM TË PROGRAMIT TË QEVERISË SHQIPTARE "PROGRAMI I KODIMIT.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do të jap një shpjegim të shkurtër për këtë projekt. Është një projekt i cili synon të japë një mbështetje nga ana e bashkisë në kuadrin e programit të madh që ne kemi në mbështetjen e sektorit të teknologjisë, informacionit dhe komunikimit. Para pak kohësh edhe qeveria shqiptare ka lançuar një program për të mbështetur të rinjtë dhe të reja që duan të trajtohen në disiplina që lidhen me kodimin, për këtë arsye ka dalë edhe një vendim i qeverisë i cili sqaron këtë mbështetje, i cili është në masën 100% për ata të rinj dhe të reja që janë punëkërkuar të papunë, ndërkohë që është në masën 50% për ata të rinj dhe të reja që janë punëkërkuar por jo të papunë dhe këtu përfshihen të rinj dhe të reja që mund të jenë të punësuar diku dhe duan të trajtohen në fushën e disiplinave të kodimit por edhe student apo të rinj të tjerë të cilët nuk janë të punësuar por nuk klasifikohen si punëkërkuar të papunë. Këta përfitojnë mbështetje në masën 50% dhe jo më tepër se 150 mijë lekë të reja, ndërkohë që kategoria e punëkërkuarve të papunë përfiton 100% dhe në masën jo më tepër se 300 mijë lekë të reja. Është bërë edhe një procedurë përzgjedhjeje nga ana e qeverisë, strukturave të ngarkuara në ne që është Agjensia Kombëtare e Punësimit. Është bërë një përzgjedhje e 4 akademive të cilat mund të behen pjesë e këtij programi. I kemi ftuar këto akademi që të prezantojnë programet e tyre të trajnimit edhe në qytetin tonë dhe në bashkinë tonë dhe të shohim kush është masa e interesit për tu përfshirë në këtë program. Janë zhvilluar disa seanca informimi open day, njëra prej tyre edhe në prezencën e ministres së rinisë. Fatmirësisht kemi një interes nga ana e të rinjve dhe të rejave të bashkisë të Korçës për të qënë pjesë e këtij programi të qeverisë. Pra ajo që kemi konstatuar është që në rastet kur mbështetja e ofruar nga qeveria është në masën 50% dhe aplikantët duhet të plotësojnë pjesën e ngelur pra 50% tjetër ka pasur një lloj hezitimi apo pamundësie financiare

për ta plotësuar këtë kontribut dhe për tu bërë pjesë e këtij programi. Prandaj kemi gjykuar që dhe ne si bashki më qënë se edhe ne kemi prioritet të punës tonë dhe të vizionit tonë të zhvillimit të qytetit dhe të bashkisë dhe për punësimin e të rinjve, qasjen ndaj teknologjisë, kemi gjykuar që dhe ne ti bashkëngjitemi kësaj iniciative të qeverisë duke i ofruar një mbështetje shtesë me qëllim që t'ju mundësojmë sa më shumë të rinjve dhe të rejave që të bëhen pjesë dhe të përfitojnë nga ky program dhe patjetër pastaj në momentin e përfundimit të këtyre trajnimeve të punësohen në kompani që në shpresojmë ti kemi prezente në qytet, kompanit të fushës së teknologjisë. Tani për të folur më konkretisht për atë çfarë propozojmë, propozojmë që këtë mbështetje ta përfitojnë ata të rinj dhe të reja që përfitojnë mbështetje në masën 50% pra grupi i 2 që janë banorë të bashkisë Korçë dhe që kanë pagë mujore më të ulët sesa paga mesatare mujore sipas referencës së INSTAT-it që aktualisht është në masën 59,242 lekë. Këtu një sqarim Megi kjo është paga bruto apo neto? Pra është paga bruto. Pra ata të rinj dhe të reja që janë punëkërkuar dhe përfitojnë janë përzgjidhur për të qënë pjesë e programit të qeverisë mbështetje nga qeveria në masën 50%, që janë banorë të bashkisë Korçë dhe në rast se janë të punësuar e kanë pagën e tyre mujore bruto më të vogël sesa paga mesatare bruto e publikuar nga INSTAT-i do të përfitojnë këtë mbështetje shtesë që unë përmenda nga ana e bashkisë. Niveli i mbështetjes të propozuar është për ata të rinj dhe të reja që janë zgjedhur nga akademi që nuk kanë siguruar mbështetje ekstra nga donatorë të ndryshëm përtej mbështetjes të qeverisë. Ne si bashki të mbështetim 50% të mbështetjes të dhënë nga qeveria. Pra për ta thënë më shkoqur 50% e 50% të qeverisë është në masën 25% të kursit. Kurse për ato akademi përveç mbështetjes të qeverisë kanë siguruar edhe mbështetje ekstra nga donatorë të tjerë ne të mbështetim diferencën nga mbështetja që kanë dhënë donatorët derisa të plotësohet masa 50% e mbështetjes të dhënë nga qeveria. Pra kjo është masa e mbështetjes që ne propozojmë dhe konkretisht numri i të rinjve dhe të rejave që kanë shprehur interesin për të qënë pjesë e këtij programi në 3 akademitë do të mbështeten nga 15 të rinj në secilën prej këtyre akademive, dhe po ta shihni në material masa e mbështetjes varion sepse SBA që është njëra prej akademive, përtej mbështetjes së qeverisë ka siguruar edhe një financim ekstra nga ana e Fondacionit Amerikan për Zhvillim prandaj dhe masa që në do të mbulojmë është më e vogël për çdo individ në masën 8,400 lekë të reja për çdo person, do të jenë 15 përfitues. Masa më e madhe e mbështetjes për çdo individ është për grupin e të rinjve që kanë shprehur interes për tu trajnuar në akademinë Betaplan Coding, këtu masa e mbështetjes për çdo individ është 66,000 lekë të reja për person, dhe për ata të rinj që janë regjistruar për të ndjekur kurset ICT Academy masa e mbështetjes është 36,000 lekë të reja për person. Shpresoj shumë që me këtë mbështetje që ne po japim të gjithë këta të rinj dhe të reja që kanë patur interes dhe dëshirë për të qënë pjesë e këtyre trajnimeve por mund të kenë pasur një stepje një hezitim apo një pamundësi që të mbulojnë koston e trajnimit me këtë mbështetje ekstra që ne po i ofrojmë sot të kenë mundësi të gjithë që të bëhen pjesë e këtyre trajnimeve dhe të kenë mundësi që këta ta plotësojnë me sukses këto kurse dhe të kenë mundësi të punësohen në kompani të programimit dhe ti kenë si model pastaj pozitive për t'ja u paraqitur edhe të rinjve dhe të rejave të tjerë të qytetit që do të duan të ndjekin këtë rrugë të punësimit dhe të të ardhurave ndaj qasjes së teknologjisë. Kështu që ju ftoj që ta miratoni këtë material, t'ja u ofroni këtë mbështetje ashtu sikundër keni mbështetur edhe iniciativa të tjera, për ti ndihmuar të rinjtë për ti dhënë aftësi, njohuri dhe dëshirën për të punuar me teknologjinë pasi besoj që realisht është një nga iniciativat më interesante dhe më të mira të bashkisë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e mundësive të punësimit të të rinjve tanë dhe me qasjen apo hapjen e aksesit për punësim në tregjet ndërkombëtare pa qënë e nevojshme që të na largohen nga qyteti.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi Nga këshilltarët ka diçka? Komisioni do të shtojë diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

INFORMACION PËR VENDIMARRJEN DHE PERFORMANCËN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022. (informacion me e-mail)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në fakt është informacion që vlen më shumë për publikun.

Sekretare E.Naçi: Kemi bërë një përmbledhje të vendimmarrjes dhe performancës së këshillit. Në mënyrë të përmbledhur aktivitet kryesore të zhvilluara sipas kategorive. Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë: Gjatë vitit 2022 janë realizuar në total 17 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 5 jashtë radhe me kërkesë të kryetarit të Bashkisë. Në total janë miratuar 177 vendime prej të cilave 1 të pa konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë. Nga vendimet e pakonfirmuara, 1 vendim është rikonfirmuar nga Këshilli duke u lënë në fuqi. Janë realizuar mbledhje komisioneve sipas materialeve përkatëse. Për shkak të karakterit emergjent të materialeve, këtë vit janë zhvilluar 5 mbledhje on-line dhe 12 mbledhje me takime fizike në sallë. Duhet theksuar që të gjitha mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar në transmetim live nëpërmjet faqes së Facebook, ç'ka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të japë dhe mendimet dhe sugjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar. Gjithashtu gjatë vitit 2022 kemi miratuar një plan aktivitetesh të shoqëruar me buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin në mënyrë që të realizoheshin aktivitetet e planifikuara. Në procesin e implementimit dhe zbatimit të rregulloreve Këshilli është asistuar nga Projekti “Bashki të Forta” i cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur vazhdimin e implementimit të këtyre standarteve në mënyrë që të rritet roli i Këshillit të Bashkisë. Në lidhje me rolin përfaqësues të Këshillit për vitin 2022, është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nëpërmjet komunikimit kryesisht nëpërmjet publikimit dhe marrjes së mendimeve nëpërmjet rrjeteve sociale por edhe në takime të përbashkëta me ekzekutivin, si buxhetimi me pjesëmarrje. Për këtë qëllim faqja e Facebook-ut e Këshillit Bashkiak Korçë e cila ka qënë aktive që në vitin 2020, ka publikuar vazhdimisht aktivitet të Këshillit dhe realizuar transmetimin livestream të mbledhjeve, gjë e cila, tashmë është pjesë e procedurave të zhvillimit të mbledhjeve. Në faqen Facebook kanë erdhur shumë mendime dhe sugjerime nga komuniteti. Anëtarët e KB, janë fokusuar gjithashtu edhe në takimet direkte me banorët e Bashkisë Korçë dhe përcjelljen e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe të KB.. Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbërritura në drejtim të Këshillit të Bashkisë. Konkretisht janë depozituar në total rreth 30 kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak. Janë trajtuar në bashkëpunim me ekzekutivin 30 kërkesa dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët. Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt-vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në

zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2022 u realizuan dhe u paraqitën në Këshill 15 informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra dhe nga vetë Këshilli. Në këtë drejtim, edhe gjatë vitit 2023, do të vijojë një bashkëpunim edhe më i mirë me administratën dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin, për përgatitjen në kohë të raporteve dhe informacioneve e planifikuara në planin e aktiviteteve të Këshillit, por edhe rast pas rasti, sipas kërkesës së KB. Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar projektin “Bashki të Forta”, për bashkëpunimin dhe asistencën për aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Korçë, ju ftojme të bëheni pjesë, për përmirësimin e punës së Këshillit nëpërmjet mendimeve dhe sugjerimeve tuaja.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Besoj dhe në këto pak mbledhje që kam mandatin të respektojme këtë impenjim publik që kemi marrë.

Pika 9 e rendit të ditës

RAPORTI I MONITORIMIT JANAR-DHJETOR 2022

Ekezekutivi D.Tabaku: Monitorimi është procesi i vlerësimit të performancës, proces i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. I gjithë ky proces është paraqitur në Raportin e Monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2022. Bashkia Korçë ka përgatitur të gjitha raportet e monitorimit, konform udhëzimit dhe brenda afateve të përcaktuara. Gjithashtu Bashkia Korçë ka zbatuar rekomandimet dhe komentet e bëra nga MFE për vitin 2022 dhe i ka reflektuar në materialet e përgatitura në vazhdimësi. Në muajin Shkurt paraqitet për informacion për periudhën Janar-Dhjetor 2022. Mund të themi që ky raport është depozituar pranë Ministrisë së Financave brenda afateve të përcaktuara. Buxheti fillestar vjetor i vitit 2022 ka qenë 1,889,324 mijë lekë, dhe pas shtesave që janë bërë gjatë vitit ka shkuar në vlerën 2,138,790. Realizimi i këtij buxheti ka qënë 1,607,320 mijë lekëose është realizuar në masën 75%. Përsa i përket realizimit të shpenzimeve sipas programit i kemi në material por unë do të paraqisja realizimin e shpenzimeve sipas llogaritjeve ekonomike të cilat janë realizuar si më poshtë: shpenzimet korrente 78% dhe shpenzimet për investime në masën 35%. Përsa i përket realizimit të shpenzimeve sipas institucioneve: institucioni i bashkiës ka realizuar buxhetin e saj në masën 60%, ndërrmarja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe cerdhes në masën 94%, ndërrmarja e shërbimeve publike 87%, dhe qëndra e artit dhe kulturës në masën 85%. Nëse do ta krahasonim realizimin e këtij buxheti me vitin 2021 themi që ka një rritje prej 8% dhe konkretisht shpenzimet e personelit kanë një rritje prej 6%, shpenzimet korrente një rritje prej 7% dhe investimet 38%. Nëse do të krahasonim sipas institucioneve dhe krahasuar me vitin 2021 do të them që bashkia ka një rritje 11%, ndërrmarja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe cerdhes 8%, ndërrmarja e shërbimeve publike 5% dhe qëndra e artit dhe kulturës 15%. Pjesë e raportit të monitorimit është dhe raportimi i detyrimeve të prapambetura që vlen për tu theksuar që bashkia Korçë detyrimet që paraqet në fund të vitit janë vetëm 291,438 lekë dhe % që ze ndaj buxhetit është 0,01%. Prandaj unë do të themi që ne jemi në një situatë shumë të mirë financiare përsa i përket raportimit të detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu treguesit fiskal të konsoliduar të bashkisë që paraqiten çdo fundviti janë të paraqitura në material dhe unë po përmend disa prej tyre, p.sh raporti i shpenzimeve të përgjithshme të të ardhurave të përgjithshme është 82% për vitin 2022 dhe krahasuar me vitin 2021 thuhet jemi në të njëjtin nivel, raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme është 50%, raporti i të ardhurave faktike nga

taksat dhe tarifat vendore ndaj planit të tyre është 71%, raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 19%, raporti i shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 35%, raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të përgjithshme është 2%, Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta është 4%, dhe disa raporte të tjera që janë të shpjeguara në material. Kjo ishte përmbledhje e raportit të monitorimit për vitin 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Totali i detyrimeve sa është

Ekezkutivi D.Tabaku : Është 291,438 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe kreditë?

Ekezkutivi D.Tabaku : Jo kredia nuk futet tek detyrimet. Vihet si informacion por nuk llogaritet në detyrimet e prapambetura. Në detyrimet e prapambetura llogariten vetëm faturat që ju ka kaluar afati 60 ditor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po detyrimet në total sa janë?

Ekezkutivi D.Tabaku : 95.966.881 bashkë me këtë pjesën që kanë ngelur të principalit të kredisë dhe të interesit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Duhet të themi një gjë të mirë se është nga të paktat bashki që ka një situatë të tillë financiare. Ndonjëherë sështe e mirë kjo, duhet të kesh borxhe më shumë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Borxhe mund të kesh sa të duash, nuk është problem për të hyrë borxh, por normalisht nga ana e disiplinës financiare nuk duhet të kesh borxhe dhe detyrime të prapambetura, në të kundërt janë detyrime që do të bien në kuriz të atyre që i kanë ofruar si shërbime apo si investime.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ne në Korçë nuk lemë gjëra pa mbyllur në përgjithësi.

Pika 10 e rendit të ditës.

POTENCIALET E SEKTORIT PUBLIK DHE PRIVAT NË SHQIPËRI PËR TË ZBUTUR NDIKIMET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE. (informacion)

Këshilltari E.Mitre: Materialin ju e keni marrë nëpërmjet email-it megjithatë unë po bëj një përmbledhje. Shqipëria është një nga vendet me të cënuara në rajon Shqipëria është një nga vendet më të cënuara në rajon për sa i përket tendencave të ndryshimeve klimatike. Modelet e ndryshimit të motit gjatë 15 viteve të fundit po përjetohen në rajon me rritje të temperaturave, ulje të reshjeve dhe ngjarje ekstreme më të shpeshta si përmytjet dhe thatësitë. Duke qenë një rajon malor, rritja mesatare e temperaturës, mbi nivelet para-industriale është tashmë 1,8 gradë C, dukshëm më e lartë se mesatarja globale prej 1,1 gradë C. Që nga vitet 1960, ka pasur një rritje prej gjashtë deri në tetë herë në intensitetin, kohëzgjatjen dhe numrin e valëve të të nxehtit në të gjithë Mesdheun lindor. Parashikimet për klimën në vitin 2050 përfshijnë rritje të mëtejshme të temperaturës, rritje të nivelit të detit dhe më shumë reshje që bien si episode të shiut intensiv në vend të bores. Në Shqipëri, të gjithë mund të ndiejmë se tashmë stinët e verës sonë janë më të gjata dhe më të nxehta, dhe dimrat janë më të butë dhe më të shkurtër. Bregdeti ynë po ngrohet 20% më shpejt se pjesa tjetër e globit dhe ne jemi një nga vendet më të goditura nga erozioni

bregdetar në Evropë. Masat e zbutjes, përshtatjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të përshkruara në Raporti dyvjeçar të Përditësimit demonstroi një angazhim të vazhdueshëm nga Qeveria për përfshirjen e ndryshimeve klimatike veprim në fusha dhe sektorë kyç. Ka një ndryshim në stinë, ndërsa gushti dikur në të kaluarën ishte muaji më i nxehtë, tani verat nisin më herët, dhe korriku ka qenë muaji më i nxehtë në dekadat e fundit. Parashikimet tregojnë një rënie të reshjeve gjatë verës. Forcimi i rrezatimit diellor raportohet të jetë rritur me 10% duke e bërë prodhimin e energjisë diellore më efikas, por gjithashtu paraqet rreziqe për shëndetin duke rritur edhe shkallën e avullimit – transpirimit. Emetimet mesatare vjetore të Green House Gas/Gaze Serre (GHG) në Shqipëri arritën në 10.8 Mt CO₂e/vit në periudhën 2009-2016. Është më pak se gjysma e emetimeve të GHG për banor se pjesa tjetër e Evropës (EU-27) Është interesante të krahasohen emetimet globale të gazeve serrë me Shqipërinë, e cila ka pak industri, por ndoshta të krahasueshme transporti/përdorimi të energjisë në ndërtesa. Duke iu referuar raporteve nderkombetare rezulton se në përgjithësi, sektorët globalë që kontribuojnë në ngrohjen më të madhe në terma afatshkurtër kohore janë burimet e dominuara nga metani, p.sh, prodhimi i energjisë (miniera, karburante fosile dhe shpërndarja), bujqësia dhe menaxhimi i mbetjeve, vihet re se:

- 73.2% e këtij ndikimi vjen nga prodhimi i energjisë apo aktivitete të lidhura me të;
- 18.4 % nga bujqësia, pyllëzimi dhe përdorimi i tokës;
- 5.2 % nga industrinë e çimentos dhe industria kimike;
- 3.2% nga menaxhimi i mbetjeve urbane dhe trajtimi i ujërave të përdorur;

Vihet re se burimet kryesore të emetimeve për Shqipërinë janë bujqësia, e ndjekur nga transporti, industria, prodhimi, ndërtimi dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta. Ndërsa emetimet nga sektori i bujqësisë tregojnë një prirje rënëse, emetimet e transportit, industrisë, prodhimit dhe ndërtimit janë në rritje. Emetimet nga mbetjet janë të konsiderueshme në afro 1 milion ton në vit, duke qëndruar pothuajse në këtë nivel për vitet e fundit. Emetimet e Gazeve Serre nga sektori i energjisë përbëjnë emetimet e çliruara si rezultat i aktivitetit të djegies së karburantit si dhe emetimet e shkarkuara nga nxjerrja e lëndëve djegëse të ngurta dhe transmetimin dhe shpërndarjen e lëndëve djegëse të lëngëta dhe të gazta. Emetimet janë të ndara në vijim sipas kategorive: Industrinë e Energjisë, Industrinë Prodhuese dhe Ndërtimi, Transporti, Sektorë të tjerë (Tregtare/Institucionale, Rezidenciale banimi dhe Bujqësi/Pylltari/ Peshkim) dhe të Paspacificuara. Përveç kësaj, ka emetime të shkarkuara nga nxjerrja e linjtit dhe nga aktivitetet e përpunimit të naftës është llogaritur. Analiza tregon se Transporti është kategoria më e rëndësishme në të gjitha vitet në vijim nga Industria e Përpunimit dhe Ndërtimi (në lidhje me konsumin e karburantit). Emetimet dhe largimet e Gazeve Serre nga sektori Bujqësisë, Pyjeve dhe përdorimit të tokës, përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të GES-ve në Shqipëri, dhe ky është gjithashtu një sektor ku zbutja e këtyre emetimeve mund të zbatohet ndjeshëm nëse politikat sektoriale bazohen në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Në kuadër të këtij sektori, pyjet mbeten emetuesit kryesorë të gazrave serrë. Sa i përket industrisë në Shqipëri, një shembull interesant mund të merret nga industria e prodhimit të çimentos. Shqipëria renditet si eksportuesi i 42të në botë, me një xhiro vjetore prej 62.5 milionë dollarë të eksportuara për vitin 2020. 9 ndërkohë duke krahasuar Shqipërinë me trendet botërore, ndërsa në Shqipëri shkarkimet e CO₂ nga industria e çimentos janë në vlerat e 299 000 m³10 (referencë viti 2014) ose 5.74 % e totalit të shkarkimeve, në botë kjo industri zë vetëm 3%. Shqipëria duhet të përshtatë ekonominë e saj me ndryshimet klimatike. Rëndësia e bujqësisë, mbështetja e Shqipërisë në prodhimin e energjisë

nga hidrocentralet dhe shndërrimi i saj në një ekonomi të varur nga turizmi e lënë atë të pambrojtur ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike. Përshtatja duhet të jetë një pjesë integrale e politikës dhe planifikimit të qeverisë. Miratimi i praktikave të menaxhimit financiar afatmesëm të gjelbër dhe strategjive afatmesme mund të ndihmojë në financimin e kostove të përshtatjes dhe përmbushjen e synimit të Shqipërisë për klimën për t'u bërë neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050. Menaxhimi i mbetjeve dhe ndikimi i GES. Devijimi nga landfilli është kontribuesi kryesor në zbutjen e GES në sektorin e menaxhimit të mbetjeve! Emetimet e Gazeve Serre nga sektori i mbetjeve mbulojnë kategoritë e mëposhtme: Depozitimi i mbetjeve të ngurta, trajtimi biologjik i mbetjeve të ngurta, djegia dhe djegia e hapur e mbetjeve dhe shkarkimi. Sistemet për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane ofrohen në shumicën e qyteteve dhe fshatrave. Është bërë shumë pak riciklim i mbetjeve. Nuk ka sisteme grumbullimi në zonat rurale dhe qytetet e vogla. Pjesa më e madhe e mbetjeve nga këto zona hidhet në kanale, gryka ose në anë të rrugëve ku ato lahen dhe hidhen në tokë të tjera dhe përfundimisht në rrjedhat ujore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po mirë janë jashtë kontekstit për ne, se për shembull ne i kemi të sistemuara.

Këshilltari E.Mitre: Mirë unë kisha edhe shumë pak.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë thjesht këtë pjesën që e dëgjojnë edhe njerëzit, se komentohet negativisht, ne i kemi përpunuar mbetjet.

Këshilltari E.Mitre: Për sqarim ky është raport për të gjithë Republikën nuk bëhet fjalë farë për në Korçë, ne jemi pothuajse të rregulluar, megjithatë nuk shpëtojmë dot nga ndotja e ajrit që është faktor shqetësues. Megjithatë po them atë fjalinë e fundit për ta mbyllur. Qeveria Shqiptare ka konsideruar çështjen e mbetjeve si një ndër gjashtë prioritetet e saj, duke i dhënë rëndësi të madhe trajtimit dhe depozitimit fundor të mbetjeve dhe duke vlerësuar që çdo njësi e vetqeverisjes vendore të ketë një vend të licensuar dhe me parametrat mjedisore për të depozituar mbetjet e tyre. Ndikimi i ndryshimeve klimatike në jetën tonë është rritur dhe tashmë është një fakt. Energjia është pjesë dhe zgjidhje e problemit. Është koha për ndryshim. Lidhja e poleve të shkencës, qeverisjes, sektorit privat dhe aktorëve të zhvillimit të bazuar në fakte dhe praktika, mundëson të reflektojmë, ndryshojmë sjellje dhe veprimet për ndryshimin, duke parë përpara për të sjelle ndryshim.

KËRKESA-ANKESA

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Ka një kërkesë në fakt që dua ta risjell në vëmendje dhe tek ekzekutivi dhe tek këshilli. Shoqata kulturore Mborjare ka kërkuar vlerësimin e figurës të z.Selim Mborja në vendosjen e një rruge ose sheshi në qytet. Mendoj që është nga ato kërkesa që vlen të merret në konsideratë.

Kryetari i bashkisë S.Filo:Patjetër që figura është e respektuar edhe me kontribut në disa drejtime në disa plane dhe është një kërkesë që ja vlen të merret në konsideratë. Tani duhet të shohim konkretisht se ku mund të kemi një hapësirë të përshtatshme për ta adresuar këtë kërkesë. Do ta shqyrtojmë me kujdes maksimal.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Një sugjerim mund të kisha p,sh që mund të përdorim dhe atë mënyrën e segmentimit në rrugë që ndahen, ka segmente të caktuara që është përdorur,

është praktikë e njohur tashmë, edhe në qytet ta shikojmë. Ka dhe një kërkesë që ka ardhur nga një zonjë që argumenton që është pasardhëse e z.Kristo Floqi të cilin ne e kemi nderuar me titullin "Qytetar Nderi". Unë nuk kam qënë në ceremoninë që u bë në këtë rast, është bërë?

Sekretare E.Naçi: Jo nuk është bërë ceremonia.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mund ta verifikojmë që është e afërme që t'ja japim. Kjo zonja që shpreh këtë, unë s'po e lexoj kërkesën se është shpërndarë, nuk përmend emra se nuk e di sa qëndron ky informacion dhe nuk dua ta bëj as publike. Nga pjesë e bashkisë mund ta ndjekë. Tani po ka më shumë pretendues të bëjmë certifikatë dhe të qetësohet kjo punë. Ku është certifikata aktualisht.

Sekretare E.Naçi: Tek qëndra e artit dhe kulturës mendoj duhet të jetë atje se ato janë marrë me organizimin e ceremonisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Këshilltare I.Nikaj: Duke folur në emër të aleancës së zgjeruar të këshilltarëve bëj me dije këshillin dhe ekzekutivin për vendimin tonë për të monitoruar 2 iniciativa të bashkisë. Iniciativa e parë nis me parastrehës emergjente të viktimave të dhunës në familje dhe e 2 ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve të ndjeshmë për luftën kundër dhunës në familje. Pra ne mendojmë që ti monitorojmë ato dhe të zhillojmë mënyrën e monitorimit si dhe efektet që ato do të kenë në plotësim të qëllimit për të cilat janë krijuar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe njëherë kërkesa është?

Këshilltare I.Nikaj: Nuk është kërkesë, është vënie në dijeni.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po si e monitoroni?

Këshilltare I.Nikaj: Po njoftoj që do ta monitorojmë, të fillojnë të vihen në zbatim sepse me fillimin e vitit buxhetore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakord ju po thoni që do e monitoroni, si mënyrën? Pra do bëni raport për këtë se ka dhe mënyra si monitorohet.

Këshilltare I.Nikaj: Po pra monitorimi do të thotë ndjekje e mënyrës se si do zbatohen këto dy nisma. Vemë në dijeni që ne do të monitorojmë këto dy nisma.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk jeni shprehur drejt nga ana ligjore, nuk jeni shprehur siç duhet. Procesi i monitorimit bëhet në disa mënyra, një mënyrë është që kërkon informacion deri ku keni vajtur me këtë dhe mund ta kërkontë që herës tjetër do të sjellim informacion.

Këshilltare I.Nikaj: Ja të fillojë viti buxhetor dhe pastaj të vazhdojmë më tutje.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Deri herës tjetër ka ikur ¼ e vitit. Deri në fund të marsit. Pastaj dhe një mbledhje kemi ne se do ndërrohet këshilli.

Këshilltare I.Nikaj: Po mirë ne mendojmë që le ta vazhdojë aleanca e pjesës tjetër nuk është në atë nxitimin tim që ta bëjë ky këshill apo kjo aleancë. Për mua perspektiva është më e rëndësishme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Ekzekutivi herës tjetër të sjellë një informacion deri ku jemi me zbatimin e këtyre dy projekteve.

Këshilltare I.Nikaj:Unë mendova që mund t'ju vinim në dijeni dhe pastaj të kërkonim informacion në një moment tjetër, dhe për ti dhënë kohë për tu përgatitur ekzekutivit. Megjithatë ju faleminderit për sugjerimin. Kisha dhe një sugjerim tjetër mëqë ishim në kuadrin e mbetjeve. Në bazë të informacioneve që ka pra vendimmarrja në nivelin botëror është që deri në 2050 pra ekonomia do të funksionojë si ekonomi rrethore me 0 mbetje, pra do të thotë që edhe planifikimi që ne kemi këtu të paraqitur do të jetë edhe në nivelin e perspektivës të asaj që do të ndodhë në kuadër të të gjithë ekonomisë botërore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga të tjerët ka diçka për të thënë? Ekzekutivi ka diçka për të shtuar? Faleminderit.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI
ERJON NEXHIPI

